

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-227/2015

**Prishtinë,
12 Prill 2018**

Në çështjen juridike të:

V. J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronave, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Ragip Namani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/252/2014 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave (më tej AKP) me numrin KPA44799 i datës 27 Gusht 2014, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 12 Prill 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga V. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës Nr. KPCC/D/A/252/2014, të datës 27 Gusht 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA44799.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/252/2014 i datës 27 Gusht 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA44799.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 16 Gusht 2007, V.J. (më tutje: pala Ankuese), ka parshtruar një kërkesë në AKP duke pretenduar të drejtën pronësore dhe kthimin e posedimit të ngastrës kadastrale 1473/3 e cilat gjenden në komunën kadastrale Sllatinë në Viti me sipërfaqe prej 2.16.60 ha. Pala Ankuese deklaroi se prona është fituar me anulimin e kontratës së vitit 1949 të lidhur mes babai i tij Mijat dhe Kooperativës Bujqësore. Posedimin e kishte humbur me datën 16 Qershor 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Aktgjykim i Gjykatës Komonale P.Br.177/94 i datës 15 Gusht 1994 me të cilin prishej kontrata e lidhur në mes të M. J. (babait të palës ankuese) dhe Kooperatës “Agromorava” dhe ngastra kadastrale 1473/3 me sipërfaqe prej 2.16.60 i kthehej Palës Ankuese .
 - Aktgjykim i Gjykatës Komonale në Viti/Vitina P.Br.176/94 i datës 15 Gusht 1994 me të cilin prishej kontrata e lidhur në mes të M.J., babait të palës ankuese, dhe Kooperativës Bujqësore “Agromorava” dhe ngastra kadastrale 442/5 me sipërfaqe prej 2.93.37 i kthehej Palës Ankuese pjesërisht.
 - Kopje plani e lëshuar nga Komuna e Vitisë me datën 16 Gusht 1994 që dëshmon se prona e kërkuar ishte në shfrytëzim të Kooperativës bujqësore “Agromorava”-Viti
 - Kopjen e Fletës Poseduese të lëshuar nga Zyra e kadastrit në Viti/Vitina me 6 Tetor 1994 me të cilën evidentohej se prona e kërkuar ishte në emër të Palës Ankuese.
 - Kopjen e fletës poseduese lëshuar nga Zyra e kadastrit në Viti/Vitina e dislokur në Serbi me 29 Shtator 2009 me të cilën evidentohej se prona e kërkuar ishte në emër të Palës Ankuese.
3. Ekipi i notifikimit i AKP-së sipas raportit të datës 17 Korrik 2008, ka konstatuar se prona e kërkuar është gjetur të jetë tokë e pa punuar dhe askush nuk kishte kryer ndonjë aktivitet mbi pronën e kërkuar. Me 22 Korrik AKP-ja kishte publikur kërkesën në gazetën nr.5 duke e shpërndarë njoftimin në zyrën kadastrale të Vitisë, UNHCR zyrara rajonale Gjilan, etj. Askush nuk ishte paraqitur për të dhënë përgjigje për kërkesën.

4. Me 30 Korrik 2010 ishte paraqitur A. K. nga Pozharani dhe kishte deklaruar se ka interes ligjor për pronën e kërkuar. Për ta mbështetur pretendimin e tij ai kishte paraqitur keto dokumente:
 - Aktgjykimi e Gjykatës Komunale në Viti P.Nr.226/94 të datës 19 tetor 1994 me të cilin i ktheheshin disa ngastrave midis te tjerav edhe ngastra 1473/2 por jo prona e kërkuar.
5. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 25 Korrik 2014, dokumentat e paraqitura nga Pala Ankuese nuk ishin gjetur dhe ishin verifikuar negatisvisht. Sipas detyrës zyrtare AKP kishte gjetur certifikatën e pronësisë të datës 25 Nëntor 2013 në të cilën figuron se prona e kërkuar evidentohet në emër të Klubit futbollistik “3 Prilli” të Vitisë. Sipas konstatimit në raportin e datës 25 Nëntor 2013 (faqe 94 në shkresate lëndës) thuhet se nga Ndermarrja “Agromorava” me vendim të Kuvendit Komunalë të Vitisë nr. 01-013/47/2001 i datës 31 Gusht 2001 i ishte ndarë Klubit futbollistik “3 Prilli” të Vitisë.
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KPCC/D/A/252/2014 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA44799 i datës 27 Tetor 2014 ka vendosur që kërkesa të refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesës fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërtimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se ai nuk ka mundur të paraqes asnjë dëshmi valide e as Sekretariati nuk ka gjetur dëshmi se para konfliktit të armatosur ka pas ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar dhe që të njetën e ka humbur si pasojë e konfliktit.
7. Gjykata gjeti se vendimi individual që i referohet kërkesës KPA44799 kishte mospërputhje në version në gjuhën serbe me vendimin grupor sepse në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se kërkesa ishte hedhur kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim thuhet se kërkesa ishte refuzuar.
8. Pala ankuese, vendimin e Komisionit e ka pranuar më 4 Mars 2015, ndërkaq ankesën ka paraqitur më datë 30 Mars 2015.

Pretendimet Ankimore

9. Pala Ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është marr në shkelje për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tej e kundërshton arsyetimin e KKPK-së se nuk e ka te qarte se a është hedhur kërkesa apo është refuzuar për shkak se ne gjuhen serbe ne vendimin individual thuhet se kërkesa është heshtur kurse në paragrafin 64 që i referohet kërkesës thuhet se ne mungesë të dëshmisë se paraqitësi i kërkesës ka pas ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar kërkesa refuzohet.
10. Pala ankuese pretendon se edhe nëse ka vendim të Kuvendit Komunal të Vitisë për dhënien e tokës Klubit Futbollistik ai është i paligjshme sepse me dokumentet e parashtruara ka dëshmuar se prona është e regjistruar në emrin e tij.

11. Bazuar ne ato qe thuhen në ankesë kërkon që Vendimi i KKPK-së të prishet dhe të konfirmohet e drejta pronësore e palës ankuese mbi pronën e kërkuar

Pranueshmëria e ankesës

12. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 4 Mars 2015, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 30 Mars 2015. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se “*ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit*”.

Meritat e Ankesës- Juridiksioni

13. Gjykata gjeti se Ankesa e parashtruar ndaj vendimit të Komisionit është e pa bazuar për faktin se paraqitësi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ka pas të drejtë pronësore të regjistruar në regjistra publik dhe se të njetën e kanë humbur si pasojë e konfliktit të armatosur dhe rrethave që lidhen me konfliktin. Dokumentat e parashtruara të palës ankuese dëshmojnë se deri në vitin 2001 prona e kërkuar ka qenë pronë shoqerore dhe tek në vitin 2001 i është ndarë Klubit futbollistik.
14. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe (b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme **private**, ku pretenduesi i pronës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësore.
15. Për këtë lëndë, është e nevojshme të përcaktohet nëse pala ankuese ka pas prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se e ka pas në shfrytëzim dhe se e ka humbur si pasojë e konfliktit. Të dhënat kadastrale tregojnë se dokumentat e parashtruara nga pala ankuese nuk janë gjetur në kadastrin e Komunes së Vitisë e as në kadastrin e zhvendosur në Serbi. Për mëteper gjatë kohës së konfliktit prona ka qenë e regjistruar si shoqerore. Neni 20 i Ligjit

mbi Mardhënjet pronësore juridike (Gaz.Zyrtare e RSFJ Nr 6/80, 36/90 parasheh se “E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”- që nënkupton formën me shkrim vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e pronës në regjistra publik. Neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80), përcakton se në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në “librin publik notar” (libri kadastral) ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/l-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 parasheh se “ 1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri..

16. Pala ankuese nuk ka dëshmuar se para konfliktit e kishte ekzekutuar të drejtë pronësore dhe posedim mbi pronën e kërkuar të cilën e ka humbur si pasojë e konfliktit dhe ky konstatim i KKKP-së nuk u kundërshtua me asnjë provë të re sipas ankesës. Këtë e dëshmojnë edhe shkresat e bashkangjitura ankesës si Certifikata e pronësisë.
17. Pala ankuese parashtroi edhe pretendimet ankimore se a është hedhur kërkesa apo është refuzuar për shkak se në gjuhën serbe në vendimin individual thuhet se kërkesa është “hedhur” kurse në paragrafin 64 që i referohet kërkesës thuhet se në mungesë të provave se paraqitesi i kërkesës ka pas ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar kërkesa refuzohet, Gjykata gjeti se është lëshim gjuhësor sepse kërkesa është refuzuar ashtu siq qëndron në vendimin grupor në të trija gjuhët në përdorim zyrtar dhe vendimi individual në gjuhën angleze dhe shqipe. Kjo për arsye të përcaktimit sipas ligjit material se në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit anglisht dhe versionit në gjuhët tjera, versioni anglisht mbizotëron bazuar në Nenin 3.3 të Urdhëresë administrative nr. 2007/5 implementimi i rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 ku parashihet se “Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet verzionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karshi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret”.
18. Prandaj edhe Gjykata e ndryshoi Vendimin në gjuhën serbe në pjesën ku kishte shperputhje me versionin në gjuhën angleze. Në pjesët tjera vendimi nuk përmbante shkelle të dispozitive procedurale e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe si i tillë u konfirmua nga Gjykata.
19. Ky aktgjykim nuk paragjykon asnjë të drejtë pronësore të konfirmuar për shfrytëzuesin aktual dhe nuk është pengesë për iniciimin e konfirmimit e të drejtave pronësore në procedurë të rregulltë.
20. Duke pas parasysh të mësipërmen, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit,

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEXI-it

Ragip Namani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referent i EULEX-it